01-914

Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve dhe Regullorës për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik nr.01.nr.110-288305 dt 31.12.2014, duke vendosur sipas kërkesës nr. 05 Nr. 350/02-121620/22 dt. 31.05.2022, të Ibrahim Jashari nga Prishtina qiramarrës në bazë të "Kontratë për qiranë e parcelës", e vërtetuar te noterja Sevdije S. Krasniqi "Vërtetim noterial i Nënshkrimit" LRP. Nr. Rend. 9388/2022 dt. 16.06.2022, për caktimin e kushteve ndertimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm afarist - autolarje, në lagjen e Muhaxherve, Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ne procedurë administrative me dt. 14.07.2022 merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I CAKTOHEN Ibrahim Jashari nga Prishtina, qiramarrës në bazë të "Kontratë për qiranë e parcelës", e përpiluar nga avokatja Myrvete Hashani-Jashari me dt.16.06.2022 e njëjta e vërtetuar te noterja Sevdije S. Krasniqi "Vërtetim noterial i Nënshkrimit" LRP. Nr. Rend. 9388/2022 dt. 16.06.2022, sipas kërkesës nr. 05 Nr. 350/02-121620/22 dt. 31.05.2022, kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndertimin e ndërtesës afarist me karakter të përkohshëm - autolarje, në kuader të parceles kadastrale nr. 06889-0 ZK Prishtinë me pronare Magbula Krasniqi.

II. Lokacioni, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, ndodhet në kuadër të bllokut urban "b_17", të nëntërësia "B-4", të tërësisë urbane "B", të Plani Rregullues Urban "Muhaxhirët" dhe Planit Zhvillimor Urban sipas së cilave plane lejohet ndërtimi I lartë miks. Ndërsa kushtet përcaktohen në bazë të kritereve te Regullorës për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Prona e Personave Fizikë dhe Juridik 01.nr.110-288305 dt.31.12.2014.

III. Gjendja ekzistuese:
- Parcela e përshkruar në pikën I te këtyre kushteve ndërtimore ka formë çrregullt,
- Sipërfaqja totale e parceles është S=287m², dhe e drejta pronësoro-juridike është private;
- Parcela ka mundësi të kyqjes në infrastrukturë teknike rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrik etj.
- Parcela kadastrale ka qasje direkte ne rrugen publike;
- Në kuader të parcelës nuk ka objekte te ndertuara.

IV. Kushtet ndertimore për ndertimin e ndërtesës së përkohshem janë:
- Vija ndërtimore ndaj vijës rregulluese, pozicionimi i ndërtesës dhe kushtet tjera për rregullimin e parcelës ndërtimore të jenë në tërësi sipas vizatimit të paraqitur si dispozitë urbanistike në përpjesë 1:200, e që janë pjesë përbërëse e kushteve ndertimore.
- Shfrytëzimi i parcelës të jetë maks. 40%,
- Etazhiteti i ndërtesës të jetë P+0;
- Destinimi i shfrytëzimit të objekteve të jetë për autolarje, me qasje nga rruga publike;
- Kuota e nivelit të përdhesës nga niveli i trotuarit mund të jetë max.30 cm;
- Shfrytëzimi i nëntokës për bodrum nuk lejohet;
- Bazamenti i objektit – themelet mund të jenë nga betoni i armuar;

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Objekti me karakter të përkohshëm duhet te ndërtohet nga materialet montuese dhe lehtë demontuese si; metali, druri, plastika apo edhe ndonje material i ngjashëm;
- Nuk lejohen elementet muratore dhe nga betoni për ndertimin e objektit;
- Distancat e objektit nga kufijtë e parcelave fqinje sipas kritereve të planit duhet të jenë min. 0.5H (H-lartësia e objektit) nga skaji i parcelës, kurse nëse në parcelat fqinje ndodhen objektet ekonomike, distanca mund të eliminohet me pëlqimin e pronarëve.
- Arkitektura e objektit ti përshtatet ambientit që e rrethon;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që uji i strehëve duhet të pikojë brenda parcelës kadastrale.
- Gjatë punimeve ndërtimore duhet ti kushtohet kujdes i veçantë në mbrojtjen e dobive natyrore dhe të mjedisit.

V. <u>Dokumentacioni ndërtimor</u>-projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normat teknike për siguri nga zjarri si dhe normat dhe standardet tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, duke përfshirë edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara dhe Udhëzimi Administrativ MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore, "Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", "Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik" 01 Nr.110-288305 dt. 31.12.2014, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin - "zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, <u>me kuota relative dhe absolute;</u>
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, <u>relative dhe absolute;</u>
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;

VI. Me dokumentacionin ndërtimor për aplikim për leje ndërtimore, bazuar në nenin 45 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, aplikuesit janë kushtëzuar që të prezantojnë:

- Deklaratën e noterizuar, se ndërtesa është me karakter të përkohshëm dhe do të largoj ndërtesën në afat prej 8 (tetë) ditësh në rast të realizimit të planit rregullues në atë hapësirë, ose edhe në rast të ndryshimit të rrethanave që nga momenti kur është dhënë leja ndërtimore e përkohshme.
- Në bazë të Urdhëresës për kufizimin e shfrytëzimit të ujit të pijshëm, nga Kryetari i Komunës dt. 15.01.2014, neni 2, nuk lejon asnjë person fizik/juridik të shfytëzojë ujin e pijshëm, për larjen e automjeteve, andaj në kërkesën për leje ndërtimore kësaj drejtorie duhet ti prezantoni zgjidhje alternative për furnizim me ujë.

Në rast të mosplotësimit të këtyre kushteve, sipas përshkrimit në këtë pikë, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit të veprojë konform rregullativës ligjore në fuqi.

VII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VIII. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për **Masat e mbrojtëse nga zjarri**, hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

Leja Mjedisore Komunale – bazuar në nenin 9, pika 1 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, përkatësisht shtojcës së këtij udhëzimi, aktiviteti i propozuar sipas projektit konceptual-kompleks me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, i nënshtrohet procedurës për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Dokumentacioni ndërtimor-Elaborati për Leje Mjedisore Komunale, i hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

IX. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarët dhe investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

X. Pagesa e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të kalkulohet/realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XI. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, si dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Kerkuesi Ibrahim Jashari nga Prishtina, qiramarrës në bazë të "Kontratë për qiranë e parcelës", e përpiluar nga avokatja Myrvete Hashani-Jashari me dt.16.06.2022 e njëjta e vërtetuar te noterja Sevdije S. Krasniqi "Vërtetim noterial i Nënshkrimit" LRP. Nr. Rend. 9388/2022 dt. 16.06.2022, me kërkesën nr. 05 Nr. 350/02-121620/22 dt. 31.05.2022, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, caktimin e kushteve ndertimore për hartimin e dokumentacionit ndertimor per ndertimin e objektit afarist me karakter te përkohshëm - autolarje në lokacionin e përshkruar në pikën I. të dispozitivit të këtyre kushteve ndertimore.

Bashkangjitur me kërkesë, kerkuesi ka prezantuar:
Kopje Plani për parcelën kadastrale nr.6889-0, e evidentuar në çertifikaten e pronësisë P-71914059-6889-0 ZK Prishtinë, kopjen e letërnjoftimit të proanrit të parcelës dhe aplikuesit; Kontratën për qiranë e parcelës" e lidhur në mes pronares së parcelës Magbula Krasniqi dhe qiramarrësit/aplikuesit Ibrahim Jashari, të përpiluar nga avokatja Myrvete Hashani-Jashari me dt.16.06.2022 e njëjta e vërtetuar te noterja Sevdije S. Krasniqi "Vërtetim noterial i Nënshkrimit" LRP. Nr. Rend. 9388/2022 dt. 16.06.2022; Vertetimin e tatimit ne prone; matjet gjeodezike; projektin ideor dhe fotografi të terrenit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 Nr. 350/02-121620/22 dt. 31.05.2022, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të "Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik" 01.nr.110-288305 dt.31.12.2014, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative dhe projektit konceptual, ka konstatuar se:

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Parcela kadastrale nr. 06889-0 ZK Prishtinë, shtrihet në kuadër të bllokut urban "b_17", të nëntërësia "B-4", të tërësisë urbane "B", të Plani Rregullues Urban "Muhaxhirët" dhe Planit Zhvillimor Urban miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013sipas së cilave plane lejohet ndërtimi I lartë miks;
- Kërkesa e aplikuesve është që, deri në hartimin e planit rregullues për atë zonë, tu lejohet që në pronën e tij të zhvillojë ndërtimin e ndërtesës së përkohshëm, dhe e njëjta të trajtohet sipas "Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik", miratuar me Vendimin e Kuvendin Komunal të Prishtinës, 01.nr.110-288305 dt. 31.12.2014;
- Në procedurë të shqyrtimit të mëtejmë, pas analizimit dhe konstatimit se projekt propozimi konceptual i prezantuar është hartuar në harmoni me kriteret e përcaktuar në "Rregullore për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik" 01nr.110-288305 dt.31.12.2014, kjo drejtori, duke u bazuar në nenin 13, pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, ka vendosur njoftimin publik me datë 29.06.2022. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkohë, nuk është pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.
- Bazuar në nenin 45 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe kriterin e përcaktuar në nenin 12 të "Rregullore për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik", 01nr.110-288305 dt.31.12.2014, kushtet ndërtimore në paragrafin VI të këtij vendimi, janë përcaktuar me kushtin e prezantimit të deklaratës së noterizuar nga pronari/shfrytëzuesi i parcelës, se ndërtesa është me karakter të përkohshëm, dhe se nuk do të jenë pengesë për realizimin/zbatimin e planit urban për atë zonë, dhe se do ti largojnë të njëjtat në afat prej 8 (tetë) ditësh, në të kundërtën vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore do të shfuqizohet.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht në nenin 21, 22, 44 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L- 110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve" dhe "Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik", 01.nr.110-288305 dt. 31.12.2014, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se aplikuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me kriteret "Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik", 01.nr.110-288305 dt. 31.12.2014, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidhja urbane".

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror – MMPHI-ja.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikueses, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr. 350/02-121620/22 dt. 31.05.2022.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 Nr. 350/02-121620/22 dt.14.07.2022

Zyrtari,	U.D. Udhëheqëse e Sektorit,	Drejtori,
Mimoza Berisha Prestreshi	Nazife Krasniqi	Arber Sadiki

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net



Legjenda:
Rrethoja
Kufiri i Parceles
Parcelat

Siperfaqja e Parceles 287m2
Siperfaqe e ndertimit 77.96m^2
Siperfaqe e gjelbrimit 112m^2

Dizajni arkitektural: Proejkti Ideor	Investor: Ibrahim Jashari			
Objekt i Përkohshem- Autolarje	Dizajnoi arkitekturën: AM Architecture SH.P.K			
Tema e faqes:	Arkitekt: Artan Millaku	Shkalla: 1:150	Formati i letrës: A3	Maj 2022
Situacioni i ngushtë		Nr i Parcelës: 6889-0 Zk Prishtinë		